



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 8 korrik 2013
Nr.ref.:RK450/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI39/13

Parashtrues

Bardhyl Krasniqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të ish-Gjykatës së Qarkut
në Prizren, KA. nr. 31/2012, të 14 marsit 2012, dhe Aktvendimit
KA. nr. 31/2012, të 20 marsit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Bardhyl Krasniqi, nga fshati Dejnë, komuna e Rahovecit.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi gjyqësor i kontestuar është Aktvendimi i ish-Gjykatës së Qarkut në Prizren (KA. nr. 31/2012) i 14 marsit 2012, dhe Aktvendimi (KA. nr. 31/2012) i 20 marsit 2012, të cilët, sipas parashtruesit, i janë dorëzuar atij më 13 prill 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të ish-Gjykatës së Qarkut në Prizren (KA. nr. 31/2012) të 14 marsit 2012 dhe të Aktvendimit (KA. nr. 31/2012) të 20 marsit 2012. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me këto aktvendime i është shkelur e drejta e tij për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); neni 47.1 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe në rregullin 28 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 14 mars 2013, parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën në Gjykatë.
6. Më 25 mars 2013, Kryetari ka caktuar gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Prof. dr. Enver Hasani (anëtarë).
7. Më 3 prill 2013, Gjykata e ka njoftuar përfaqësuesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë dokumentet e nevojshme për kompletimin e kërkesës.
8. Më 12 prill 2013, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Themelore në Prizren të sigurojë dosjen complete të lëndës së parashtruesit të kërkesës, duke përfshirë: aktakuzën e Prokurorit Publik të Qarkut (PP. nr. 239/2011) të 20 shkurtit 2002 dhe vendimet e të gjitha instancave gjyqësore.
9. Më 23 prill 2013, Gjykata pranoi shkresën I. GJA. nr. 1/13-61, të 18 prillit 2013 nga Gjykata Themelore e Prizrenit, e cila e njoftoi Gjykatën Kushtetuese se shkresat e lëndës (P. nr. 61/12) i janë transferuar Gjykatës Themelore në Gjakovë, sipas kompetencës lëndore.
10. Më 13 maj 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë i dorëzoi shkresat complete të lëndës së parashtruesit, në pajtim me kërkesën e Gjykatës.
11. Më 19 qershor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës që kërkesa të shpallet e papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 20 shkurt 2012, Prokurori Publik i Qarkut në Prizren paraqiti aktakuzën (PP. nr. 239/2011) kundër parashtruesit dhe vëllait të tij, z. Halil Krasniqi, duke i akuzuar ata për vrasje dhe për ndihmë në kryerjen e vrasjes, nga neni 146 në lidhje me nenin 25 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK).
13. Më 14 mars 2012, ish-Gjykata e Qarkut në Prizren (KA. nr. 31/12) e konfirmoi aktakuzën kundër parashtruesit dhe z. Halil Krasniqi. Parashtruesi dhe z. Halil Krasniqi u deklaruan të pafajshëm lidhur me këto akuza penale. Në pjesën përfundimtare të aktvendimit përkitazi me konfirmimin e aktakuzës, Gjykata deklaroi:

“Megenëse gjyqtarja për konfirmimin e aktakuzës ka ardhur në përfundim se nuk ekzistojnë rrethanat për hedhjen poshtë të aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale kundër të pandehurve për veprat penale për të cilat ata akuzohen, të parapara me nenin 316 par. 1-3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK-së) dhe aktakuza përmban prova të mjaftueshme, që arsyetojnë dyshimin e bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale me të cilat akuzohen, ndaj dhe e konfirmoi të njëjtën. Prandaj, Gjykata vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 316 par. 4 dhe nenin 318 par. 1 pika 1 dhe par. 2 të KPPP-së”.

14. Më 20 mars 2012, ish-Gjykata e Qarkut në Prizren nxori Aktvendim KA. nr. 31/12, duke e ndryshuar Aktvendimin e mëparshëm (KA. nr. 31/12) të 14 marsit 2012 në pjesën hyrëse, duke e hequr veprën penale të vrasjes, të paraparë me nenin 146 të KPPK-së dhe të ndihmës në kryerjen e veprës penale të vrasjes nga neni 146 në lidhje me nenin 25 të KPPK-së, duke i zëvendësuar me veprën penale të bashkëkryerjes së vrasjes së rëndë nga neni 147 paragrafi 1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPPK-së. Gjykata e arsyeton ndryshimin e aktvendimit si më poshtë:

“Me Aktvendimin e kësaj gjykate KA. nr. 31/12 të 14 marsit 2012 është konfirmuar aktakuza ndaj të akuzuarve Halil Krasniqi dhe Bardhyl Krasniqi [...], për shkak se në bashkëkryerje ata kanë kryer veprën penale vrasje e rëndë nga neni 147 par. 1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPPK-së. Gjyqtarja për konfirmimin e aktakuzës konstatoi se gjatë përpilimit të aktvendimit është bërë një lëshim dhe atë në pjesën hyrëse, në dispozitiv dhe arsyetim, ku në vend të veprave penale të vrasjes nga neni 146 të KPPK-së dhe vrasjes në ndihmë nga neni 146 lidhur me nenin 25 të KPPK-së, duhet të qëndrojë vetëm vepra penale e kryer në bashkëkryerje të vrasjes së rëndë nga neni 147 par. 1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPPK-së”.

15. Më 20 prill 2012, mbrojtësi i parashtruesit parashtrroi ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme) kundër Aktvendimit të ish-Gjykatës së Qarkut (P. nr. 61/12) të 20 prillit 2012, përkitazi me vazhdimin e paraburgimit/konfirmimit dhe ndryshimit të aktakuzës ndaj parashtruesit dhe vëllait të tij, z. Halil Krasniqi.
16. Më 23 prill 2012, ish-Gjykata e Qarkut në Prizren ia dorëzoi Gjykatës Supreme shkresat e lëndës P. nr. 61/12, përkitazi me të akuzuarit.

17. Më 19 dhjetor 2012, Gjykata Supreme, me Aktvendimin P. nr. 300/2012, e refuzoi si të pabazuar ankesën mbrojtësit të ushtruar kundër Aktvendimit të ish-Gjykatës së Qarkut në Prizren (P. nr. 61/2012) të 20 prillit 2012.
18. Më 19 dhjetor 2012, ish-Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktvendimi P. nr. 61/2012) mori vendim për zgjatjen e paraburgimit, siç thuhet në aktvendim, edhe për 2 (dy) muaj, deri më 21 shkurt 2013.
19. Më 14 shkurt 2013, Prokurori i Shtetit, përkatësisht Departamenti për Krime të Rënda, në pajtim me nenin 193 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe nenit 187 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, 1.2, pika 1.2.1, 1.2.3 të KPPK-së, parashtoi kërkesë për vazhdimin e paraburgimit kundër parashtruesit dhe vëllait të tij, z. Halil Krasniqi.
20. Më 19 shkurt 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë, me Aktvendimin P. nr. 61/12 PZ1, të 19 prillit 2013, ia vazhdon paraburgimin të akuzuarit Halil Krasniqi, parashtruesit, nga 21 shkurti 2013 deri më 21 prill 2013.
21. Më 19 prill 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë, me Aktvendimin P. nr. 61/12 PZ1, të 19 prillit 2013, parashtruesit dhe të akuzuarit, z. Halil Krasniqi ua vazhdon paraburgimin, prej 21 prillit 2013 deri më 21 qershor 2013.
22. Duket se shqyrtimi kryesor në çështjen penale kundër parashtruesit nuk ka filluar ende.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ish-Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktvendimin KA. nr. 31/2012 të 14 marsit 2012 dhe siç ndryshohet më 20 mars 2012, ia ka shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjikim të Drejtë dhe të Paanshëm].
24. Parashtruesi pretendon se autoriteti gjyqësor me aktvendimet në fjalë ka bërë shkelje të ligjit penal dhe shkelje të të drejtave themelore të tij, duke e akuzuar dhe mbajtur atë padrejtësisht në paraburgim për veprën penale të “vrasjes së rëndë në bashkëkryerje” nga neni 147 paragrafi 1 pika 4 e KPPK-së. Ai pretendon se gjykata nuk është e paanshme, për shkak të lidhjeve familjare të prokurorit dhe mjekut ligjor me viktimën e vrasjes së pretenduar.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë së kërkesës të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës, përkitazi me.
26. Në këtë rast, Gjykata i referohet nenit 113 paragrafi 1 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] që përcakton se:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

27. Neni 47 (2) i Ligjit për Gjykatë Kushtetuese gjithashtu përcakton se:

“Individi mund ta ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit i cili parasheh se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

29. Për më tepër, rregulli 36 (1) (a) dhe (c) i Rregullores parasheh që:

(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar;

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit;

c) kërkesa është qartazi e bazuar.

30. Gjykata, nga shkresat e lëndës, vëren se parashtruesi i kërkesës i konteston vendimet e ish-Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, me të cilat pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]. Ai më tutje pohon se, ish-Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktvendimin KA. nr. 31/12 të 20 marsit 2012 ka bërë shkelje të ligjit penal dhe shkelje të të drejtave themelore të tij, duke e akuzuar dhe mbajtur padrejtësisht atë në paraburgim për veprën penale të “vrasjes së rëndë në bashkëkryerje nga neni 147 paragrafi 1 pika 4 e KPPK-së. Ai pretendon se gjykata nuk është e paanshme.

Sa i përket procedurës paraprake

31. Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi i kërkesës, me asnjë provë nuk tregon, si dhe pse ish-Gjykata e Qarkut në Prizren ia ka shkelur atij të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

32. Sa i përket pretendimit për shkeljen e ligjit penal, nga ish-Gjykata e Qarkut në Prizren, Gjykata konsideron se ato pretendime mund të jenë të fushës së ligjshmërisë. Është juridiksion i gjykatave të rregullta që t'i aplikojnë dispozitat

përkatëse të ligjit, në përputhje me dritën e rrethanave të rastit, në rastin konkret, me peshën e veprës penale të ngarkuar.

33. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1.c) të Rregullores së punës, e cila përcakton se:

“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) Kërkesa është qartazi e bazuar”.

34. Gjykata dëshiron të përkujtojë se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të trajtojë gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përderisa ato nuk i shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
35. Andaj, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur i shqyrton vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe të së drejtës materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz vs. Spain [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
36. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse të ish-Gjykatës së Qarkut kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, Shub vs. Lithuania, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
37. Sidoqoftë, parashtruesi nuk shpjegon pse dhe si i janë shkelur të drejtat e tij, ai nuk e mbështet pretendimin *prima facie* mbi baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, i janë shkelur nga ish-Gjykata e Qarkut në Prizren. Parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij se prokurori dhe mjeku ligjor kanë lidhje familjare me viktimën e krimit, për të cilin ai është akuzuar dhe as nuk ka treguar se si këto lidhje të pretenduara familjare kanë ndikuar në aktgjykimin e ish-Gjykatës së Qarkut në Prizren.

Sa i përket shqyrtimit kryesor të rastit

38. Gjykata vëren se Aktvendimi i kontestuar i ish-Gjykatës së Qarkut në Prizren (KA. nr. 31/2012) i 20 marsit 2012 i është dorëzuar parashtruesit më 12 prill 2012. Gjykata Kushtetuese i pranoi shkresat e lëndës së parashtruesit më 27 prill 2013, me ç’rast ka kuptuar se parashtruesit i ishte vazhduar paraburgimi, disa herë, fillimisht nga ish-Gjykata e Qarkut në Prizren dhe më pas nga Gjykata Themelore në Gjakovë (Aktvendimi P. nr. 61/12 PZ1 i 19 prillit 2013), prej 21 prillit 2013 deri më 21 qershor 2013.
39. Pas 13 majit 2013, Gjykata Kushtetuese nuk posedon asnjë informatë përkitazi me shqyrtimin kryesor të rastit. Prandaj, meqë rasti i parashtruesit është ende në fazën e procedurës paraprake dhe parashtruesi prapë do të ketë mundësi të shumta t’i paraqesë pretendimet e tij për njëanshmëri gjyqësore gjatë

procedurës së gjykimit kryesor, nga ky këndvështrim, Gjykata konsideron se kërkesa është e parakohshme. Si e tillë, shtrohet pyetja se a i ka shteruar parashtruesi të gjitha mjetet juridike në dispozicion.

40. Në pajtim me parimin e subsidiaritetit, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është i detyruar të shterë të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, siç parashihet në nenin 113 (7) të Kushtetutës dhe në dispozitat e tjera ligjore, të cilat u përmendën më lart.
41. Në të vërtetë, qëllimi i rregullit të shterimit është që gjykatave të rregullta t'u ofrohet mundësia e korrigjimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli i shterimit është në mënyrë funksionale i ndërthurur me karakterin e subsidiaritetit të kornizës procedurale të drejtësisë kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis*, Selmouni kundër Francës [GCI, § 74; Kudla kundër Polonisë [GCI, § 152; Andrashik dhe të tjerët kundër Sllovakisë [dec.]]).
42. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Ndryshe, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo nëse dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Ai dështim do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për të kundërshtuar më tej shkeljen e pretenduar (Shih, Aktvendimin në rastin KIO7/09, Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18).
43. Kurdo që kontestohet një vendim në bazë të një qëndrimi juridik që është i papranueshëm nga pikëvështrimi i të drejtave dhe i lirive themelore të njeriut, gjykatave të rregullta që sollën vendimin, duhet ofruar mundësinë e rishqyrtimit të vendimit të kontestuar. Kjo do të thotë se, çdoherë kur pretendohet shkelja e të drejtave të njeriut, nuk është e thënë që ky pretendim të arrijë në Gjykatën Kushtetuese para se të shqyrtohet paraprakisht nga gjykatat e rregullta.
44. Prandaj, Gjykata gjen se, parashtruesi i kërkesës as nuk ka ndërtuar, e as nuk ka dëshmuar një rast *prima facie*, qoftë mbi bazën e meritave apo pranueshmërisë së kërkesës.
45. Nga arsyet e cekura si me sipër, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit përkitazi me procedurën paraprake të konfirmimit të aktakuzës, në pajtim me rregullin 36.1 pikën (c) të Rregullores së punës, konsiderohet si qartazi e pabazuar.
46. Në tërësi, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36.1 (c) dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores, më 8 korrik 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani